



Pranimi / Dohetuar Prilbena/Protobila Received/ Delivered	04. 08 2023	3	Viti Year
Organizues Organizator Org. Unit	In Prot In Prot Prot No	Shënim Prilog Appendix	Sasia Kopjime Quantity
SIGNSHM	5550/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.828/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.828/2023 të datës 09.06.2023 të parashtruar nga ankuesja

të përfaqësuar me autorizim nga avokati, kundër përgjigjes me numër 2332/2023 të datës 11.05.2023 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 04.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.828/2021 e datës 09.06.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit pas marrjes së autorizimit të Drejtorit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil për shpalljen e konkursit për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Promovim Kulturor në Departamentin e Kulturës" me datën 04.09.2019 ka shpall konkursin në fjalë në të cilin konkurs ka qenë kandidatë edhe ankuesja. Me datën 07.10.2019 kjo procedurë e rekrutimit është pezulluar sipas njoftimit të Ministrisë së Administratës Publike si Ministri përgjegjëse, për shkak të hyrjes në fuqi të

Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaar Publik, deri ne momentin e pezullimit sipas njoftimit të lartshënuar Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit lidhur me pozitën e punës " Zyrtaar i Larte për promovim Kulturor ne Departamentin e Kulturës" kishte përfunduar edhe intervistën me goje.

Me tutje sipas njoftimit të datës 09.01.2020 nga Ministria e Administratës Publike për vazhdimin e procedurës se rekrutimit pas Ligjit nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Kosovës, Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit ka bërë njoftimin përfundimtar për konkursin në fjalë me datën 15.01.2020 kështu që ankuesja ka qenë e përzgjedhur si kandidatja me e suksesshme sipas njoftimit me numër Nr.57/2019. Ndërsa me date 03.02.2020 kandidati A. Gallapeni ka parashtruar ankesë pranë Komisionit për Zgjedhën e Kontesteve dhe Ankesave lidhur me konkursin për pozitën e punës "Zyrtaar i Larte i Promovimit" , ndërsa kjo e fundit me datën 04.03.2020 ka marr vendimin me numër 963/2020 me të cilin e ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e anuluar vendimin me numër nr.113/2020 të datës 15.01.2020 për kandidaten e përzgjedhur.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin me numër 963/2020 të datës 04.03.2020 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave ne Ministrin e Kulturës Rinis dhe Sportit me date 01.04.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 18.06.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrativ

Ankuesja e pa kënaqur me njoftimin me numër të protokollit 1187/2020 e datës 18.06.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrativë, ndërsa kjo e fundit me datën 16.06.2021 ka nxjerr aktgjykimin me të cilin Këshillin e Pavarur e ka obliguar që të merr vendim lidhur me ankesën e ankueses.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 07.07.2021 ka njoftuar Gjyqtarin e Gjykatës Themelore dhe palën në procedure lidhur me mos funksionimin e Këshillit dhe kjo e ka bërë të pa mundur vendosjen e ankesës së ankueses sipas Aktgjykimit A.nr.686/2020, dhe e njëjta eshte udhëzuar që të vazhdojnë me proceduarat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Ankuesja e pa kënaqur me njoftimin e datës 07.07.2021 ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtine /Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa

kjo e fundit me datën 21.11.2022 ka marr Aktgjykimin me numër A.nr.872/2022 me të cilin e ka anuluar njoftimin e datës 07.07.2021 duke e obliguar Këshillit që të vendos lidhur me ankesën e ankueses, ku Këshilli me datën 01.12.2022 ka pranuar të njëjtin Aktgjykim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 17.01.2023 ka vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.540/2021 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankueses si të bazuar duke e lenë ne fuqi Njoftimin numër të protokollit 113/2020 te datës 15.01.2020 për kandidaten e suksesshme për pozitën „Zyrtar i Lartë për Promovim Kulturor“ në Departamentin e Kulturës“ në Ministrinë e Kulturës Rinise dhe Sportit, dhe duke e obliguar Sekretarin e Përgjithshëm qe ankuese ti lëshoj akt emërimin për pozitën „Zyrtar i Lartë për Promovim Kulturor“ .

Menaxheri i Personelit në Ministrinë e Kulturës Rinise dhe Sportit në zbatim të vendimit me numër A nr.540/2021 të datës 17.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 12.02.2023 Ankueses [REDACTED] i ka lëshuar akt emërimin me Nr.02/2023 ne pozitën „Zyrtar i Lartë për Promovim Kulturor“ në Departamentin e Kulturës“.

Ankuesja me datën 24.04.2023 ka parashtruar kërkesë me numër 2022/2023 tek Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm, përmes se cilës ka kërkuar kompensimin retroaktiv të pagave nga data 15.01.2020 respektivisht nga data e shpalljes se njoftimit me për kandidaten e suksesshme për pozitën „Zyrtar i Lartë për Promovim Kulturor“ në Departamentin e Kulturës deri me datën 13.02.2023 data kur i është lëshuar Akti i emërimit. Ndërsa Udhëheqësi i personelit me datën 11.05.2023 i ka kthyer përgjigje përmes se cilës i ka refuzuar kërkesën për kompensimin retroaktiv të pagave.

Ankuesja e pa kënaqur me përgjigjen e datës 11.05.2023 të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinise dhe Sportit me datën 09.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4647/2023 pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimore se të njëjtës organi i punësimit duhet që ti kompensoj pagën në mënyrë retroaktive në vlerën prej pesëqind e tridhjetë (530) euro nga data 15.01.2020 deri me datën 13.02.2023 .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinise dhe Sporti. Ndërsa Këshilli me datë 16.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë me 20.06.2023 ka nxjerrë Vendimin VK/2023 më numër prot:

5314/2023, përmes të cilit ankesës së ankueses ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4647/2023 të datës 09.06.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër A.nr.540/2023 të datës 17.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërimin me numër Nr.02/2023 të datës 13.02.2023; Kërkesën me numër protokolli 22/20233 të datës 24.04.2023; Përgjigjeni në kërkesë të datës 10.05.2023; Kërkesën për përgjigjen në ankesë të datës 12.06.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 6.04.2023; Emalin e datës 12.06.2023 të T.Balaj drejtuar SH.Ismajli; Autorizimin e datës 02.09.2019; Vendimin me numër të protokollit 5314/2023 të datës 20.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ne baze te administrimit te provave ka gjetur se Menaxheri i Personelit në Ministrinë e Kulturës Rinise dhe Sportit në zbatim të vendimit me numër A nr.540/2021 të datës 17.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës me datën 13.02.2023 ankueses [redacted] i ka lëshuar Akt emërimin me Nr.02/2023 për pozitën „Zyrtar i Lartë për Promovim Kulturor“ në Departamentin e Kulturës, dhe e njëjta sipas këtij Akt emërimi nga data 13.02.2023 e ushtron detyrën ne vendin e punës „Zyrtare e Larte për Promovimin Kulturor “ne Departamentin e Kulturës, me koeficient (8) tetë.

Ankuesja pas nënshkrimit të Akt emërimin me datën 13.02.2023 sipas vendimit me numër A nr.540/2021 të datës 17.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës, me datën 24.04.2023 ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit përmes se cilës ka kërkuar kompensimin retroaktiv të pagave nga data 15.01.2020 deri me datën 13.02.2023, ndërsa i njëjti me datën 11.05.2023 i ka kthyer përgjigje përmes se cilës i ka refuzuar kërkesën për kompensimin retroaktiv të pagave.

Ankuesja me date 24.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes se cilës pretendon se organi i punësimit duhet që ti kompensoj pagën në mënyrë retroaktive nga data 15.01.2020 respektivisht nga data e shpalljes se njoftimit për kandidaten e suksesshme për pozitën „Zyrtar i Lartë për Promovim Kulturor“ në Departamentin e Kulturës deri me datë 13.02.2023 data kur i është lëshuar Akt emërimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në provat e lëndës, konstaton se ankuesja pozitën “Zyrtare e Larte për Promovim Kulturor” ne Departamentin e

Kulturës“ e ka ushtruar sipas Akt emërimit me numër të protokollit 659/2023 nga data 13.02.2023. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se përderisa ne shkresat e lendes nuk ka pasur asnjë vendim apo konfirmim zyrtar i cili dëshmon se e njëjta ka ushtruar pozitën *“Zyrtare e Lartë për Promovim Kulturor në Departamentin e Kulturës”*, për periudhën për të cilën ankuesja e kërkon kompensimin e pagës nga data 15.01.2020 deri me datën 13.02.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimi i ankuese për kompensim gjate kësaj periudhe është i pabazuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke i referuar Vendimit KZKA nr. 02/2020 të datës 04.03.2020 te Komisionit për Përzgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në dispozitiv të Vendimit me A.nr.540/2021 te datës 17.01.2023 e ka shfuqizuar Vendimin e lartpërmendur dhe Njoftimin me numër protokollit 1044/2020 te datës 11.03.2020 te Ministrisë se Kulturës Rinise dhe Sportit, duke e lenë ne fuqi Njoftimin numër të protokollit 113/2020 te datës 15.01.2020 për kandidaten e suksesshme për pozitën *„Zyrtar i Lartë për Promovim Kulturor“* në Departamentin e Kulturës“ në Ministrinë e Kulturës Rinise dhe Sportit, si ka obliguar Sekretarin e Përgjithshëm gjegjësisht Ministrinë e Kulturës Rinise dhe Sportit qe qe te krijojë lidhje kontraktuale respektivisht ankuses ti lëshoj Akt emërimin për pozitën *„Zyrtar i Lartë për Promovim Kulturor“*, dhe jo te beje kompensimin sepse ka munguar lidhja kontraktuale në mes punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Bazuar në të gjitha të lartcekurat, po ashtu edhe duke ju referuar dispozitave ligjore në fuqi, përcaktohet që zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, siç parashihet me nenin 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili ka qene në fuqi gjatë periudhës ku ankuesja pretendon se i takon kompensimi përkatësisht neni 9 paragrafi 1, ka përcaktuar që: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës”*, andaj si rrjedhojë meqenëse ankuesja nuk ka pasur asnjë akt juridik që ka ushtruar detyrat e punës për pozitën *“Zyrtare e Lartë për Promovim Kulturor në Departamentin e Kulturës”* nga data 15.01.2020 deri me datën 13.02.2023, atëherë nuk mund të bëhet asnjë lloj kompensimi për këtë çështje, rrjedhimisht edhe pretendimi i saj për kompensimin e të ardhurave personale nga data 15.01.2020 deri me datën 13.02.2023 është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se përgjigja me numër 2337/2023 e datës 11.05.2023 e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinise dhe Sportit , është nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimi i ankuses është i pabazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 dhe 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.828/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim avokat 
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.